FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

LOPERAMID

Tableta - 2 mg
(Loperamid klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

1. Çfarë është Loperamid dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Loperamid
3. Si ta merrni Loperamid
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Loperamid
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË LOPERAMID DHE PËRSE PËRDORET

Loperamid është një antidiarreik i fuqishëm sintetik. Ai vepron drejtpërdrejt në paretet e zorrëve, ku lidhet me receptorët e opiateve, të cilët ngadalësojnë lëvizshmërinë e zorrëve. Loperamid frenon kështu veprimtarinë peristaltike, e cila çon në uljen e humbjes së lëngjeve dhe të elektrolitëve nga zorrët. Në këtë mënyrë vëllimi ditor i feçeve zvogëlohet, ndërkohë që veshtullia dhe dendësia e masës rritet.
Loperamid përdoret në mjekimin simptomatik të diarresë akute me etiologji të ndryshme, duke përfshirë edhe përkeqësimin akut të saj në të rriturit dhe fëmijët mbi 12 vjeç (në moshat 6 – 12 vjeç mund të përdoret vetëm me përshkrimin e mjekut).
Në mjekimin e diarresë kronike përdoret vetëm në të rriturit.
Në të sëmurët me ileostomi mund të përdoret për të ulur numrin dhe vëllimin e defekimeve dhe për të forcuar konsistencën e feçeve.

2. PËRPARA SE TË MERRNI LOPERAMID

Mos merrni Loperamid në qoftë se:
- jeni i ndjeshëm (alergjik) ndaj loperamid klorhidratit ose ndaj ndonjërit prej përbërësve të tjerë të tabletës;
- frenimi i peristaltikës duhet mënjanuar, sepse në të tilla raste ka rrezik që të shfaqet ileus, megakolon dhe megakolon toksik;
- keni fryrje abdominale, ileus, konstipacion; trajtimi duhet të ndërpritet menjëherë;
- vuani nga kolit pseudomembranoz i shkaktuar nga përdorimi i antibiotikëve me spektër të gjerë veprimi;
- vuani nga koliti ulçeroz akut;
- vuani nga enterokoliti bakterial i shkaktuar nga: Shigela, Salmonela, Kampilobakter.

Loperamid nuk duhet përdorur i vetëm në dizenteri akute, e cila karakterizohet nga feçe me gjak dhe temperaturë të lartë.
Loperamid është i kundërindikuar në insufiçiencën hepatike për shkak të mundësisë së mbidozimit relativ.
Loperamid nuk duhet të përdoret në fëmijët më të vegjël se 6 vjeç, por edhe në moshat 6 – 12 vjeç nuk rekomandohet dhe mund të përdoret vetëm me përshkrimin e mjekut.

Tregoni kujdes të veçantë me Loperamid
Pyesni mjekun tuaj përpara se të merrni Loperamid.
Loperamid ka një efekt simptomatik në diarrenë akute dhe kronike me origjinë joinfektive. Gjatë diarresë organizmi humbet lëngje ndaj merrni lëngje dhe elektrolitë, si dhe zbatoni një dietë të përshtatshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët.
Në qoftë se diarrea nuk kontrollohet brenda 48 orësh, atëherë duhen identifikuar shkaqe të tjera të kësaj patologjie.
Përdorimi afatgjatë i Loperamid është mirë të mënjanohet.
Kujdes duhet treguar në të moshuarit dhe në të sëmurët me çrregullim të theksuar të funksionit të mëlçisë, në të cilët shenjat e efekteve helmuese në sistemin nervor qendror mund të bëhen të dukshme.
Në dyshimin më të vogël për megakolon toksik, mjekimi me Loperamid duhet të ndërpritet menjëherë.
Nuk ka të dhëna për efekte të dëmshme të barit gjatë periudhës së shtatzënisë. Megjithatë, ai në këtë periudhë duhet të përdoret vetëm në raste urgjente dhe vetëm kur dobia potenciale për nënën e justifikon rrezikun potencial për fetusin.
Ndonëse pjesa e barit që jashtëqitet me qumështin e gjirit është tepër e ulët, rekomandohet që ushqyerja me gji të ndërpritet gjatë mjekimit.
Në disa të sëmurë Loperamid mund të shkaktojë marrje mendsh dhe lodhje. Në të tilla raste, mos drejtoni automjetin dhe mos përdorni makineri derisa efektet e padëshirueshme të zhduken plotësisht.
Nuk rekomandohet përdorimi i tabletave nën moshën 12 vjeç. Mos i merrni këto tableta për asnjë qëllim tjetër përveç atij të rekomanduar dhe asnjëherë mos e tejkaloni dozën e dhënë (pika 3). Në pacientët që kanë marrë doza të larta të loperamidit janë raportuar probleme serioze të zemrës (simptomat përfshijnë rrahje të shpejta ose të parregullta të saj).

Marrja e barnave të tjera
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Loperamid.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë.
Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Loperamid në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.
Është veçanërisht e rëndësishme që mjeku juaj të jetë në dijeni të faktit që ju jeni trajtuar me:
- analgjezikë opioidë, sepse përdorimi i kombinuar i loperamidit me analgjezikët opioidë mund të shkaktojë konstipacion të rëndë;
- barna që frenojnë ose përshpejtojnë peristaltikën gastrointestinale;
- desmopresin: loperamidi rrit përqëndrimin plazmatik të desmopresinës orale;
- itrakonazol: rrit përqëndrimin plazmatik të loperamidit;
- ritonavir: rrit biodisponibilitetin e loperamidit;
- gemfibrozil: rrit përqëndrimin plazmatik të loperamidit;
- ko-trimoksazol: rrit biodisponibilitetin, frenon metabolizmin hepatik të loperamidit;
- kinidinë: rrit hyrjen e loperamidit në SNQ.

Loperamid mund të përdoret edhe me barna të tjera (p.sh. kemoterapeutikë, kortikosteroidë, antihelmintikë).

Marrja e Loperamid me ushqim dhe pije
Mund të merret me gjysmë gote ujë.

Shtatzënia
Kërkoni këshillën e farmacistit ose të mjekut përpara se të merrni këtë bar!
Nuk ka të dhëna për efekte të dëmshme të barit gjatë periudhës së shtatzënisë. Megjithatë, ai në këtë periudhë duhet përdorur vetëm në raste urgjente dhe vetëm kur dobia potenciale për nënën e justifikon rrezikun potencial për fetusin.

Ushqimi me gji
Ndonëse pjesa e barit që jashtëqitet me qumështin e gjirit është tepër e ulët, rekomandohet që ushqyerja me gji të ndërpritet gjatë mjekimit.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Në disa të sëmurë Loperamid mund të shkaktojë marrje mendsh dhe lodhje. Në këto raste, nuk duhet të drejtoni automjetin dhe të përdorni makineri derisa efektet e padëshirueshme të zhduken plotësisht.

Informacione të rëndësishme mbi disa nga përbërësit e Loperamid
Ky bar përmban laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3. SI TA MERRNI LOPERAMID

Gjithmonë merreni Loperamid sipas këshillës së mjekut ose farmacistit. Në qoftë se nuk jeni i sigurt, kontaktoni me mjekun ose farmacistin. Në qoftë se ndjeni që efektet e Loperamid janë shumë të forta ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj. Tabletat duhet të merren me të paktën gjysmë gote ujë.
Mjekimi i diarresë zakonisht fillohet me zëvendësimin e lëngjeve të humbura (rehidrimi nga goja). Bazuar në konsideratat e mjekut ose farmacistit, mund të fillohet mjekimi i njëkohshëm me loperamid. Në qoftë se pas 48 orësh nuk arrihet një efekt terapeutik i përshtatshëm, atëherë mjekimi me Loperamid duhet ndërprerë.

Diarre akute:
Të rriturit dhe fëmijët mbi 12 vjeç
4 mg (2 tableta) dhe vazhdohet me 2 mg (1 tabletë) pas çdo defekimi të ujshëm.
Doza e zakonshme është 3 – 4 tableta në ditë. Nuk duhet të tejkalohet doza prej 8 tableta (16 mg) në ditë.

Fëmijët nën 12 vjeç
Loperamid nuk duhet të përdoret në fëmijët më të vegjël se 6 vjeç, por edhe në moshat 6 – 12 vjeç nuk rekomandohet dhe mund të përdoret vetëm me përshkrimin e mjekut.

Diarre kronike:
Përdoret vetëm tek të rriturit dhe doza përcaktohet nga mjeku.
Mjeku juaj do t'ju këshillojë në përputhje me rrethanat.

Në qoftë se keni marrë më shumë Loperamid
Në qoftë se keni marrë më shumë tableta Loperamid sesa duhet, njoftoni menjëherë mjekun ose spitalin për tu këshilluar.
Simptomat mund të përfshijnë: rrahje të shpejta të zemrës, rrahje të parregullta të saj, ndryshime të ritmit të zemrës (këto simptoma mund të kenë pasoja potencialisht serioze, kërcënuese për jetën), ngurtësim të muskujve, lëvizje të pakoordinuara, përgjumje, vështirësi në urinim, ose frymëmarrje të dobët.
Fëmijët reagojnë më shumë ndaj dozave të larta të loperamidit sesa të rriturit. Nëse një fëmijë merr një dozë të lartë apo shfaq ndonjë nga simptomat e mësipërme, informoni menjëherë mjekun.

Në qoftë se harroni të merrni Loperamid
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), merrni dozën në vazhdim kur të jetë koha për marrjen e zakonshme të saj.
Mos merrni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Si të gjitha barnat e tjera, Loperamid mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston. Ndonjëherë ato janë serioze, ndonjëherë jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.
Në dozat e rekomanduara dhe kur mbahen parasysh kundërindikimet, nuk janë vërejtur efekte të padëshirueshme të rëndësishme, madje edhe pas përdorimit afatgjatë. Efektet e padëshirueshme të raportuara nga përdorimi i loperamidit është e vështirë që të dallohen nga simptomat që shoqërojnë sindromin diarreik.
Efektet anësore që mund të shfaqen janë:

Të zakonshme ose shumë të zakonshme: marrje mendsh, flatulencë (prezencë gazrash në abdomen), dhimbje koke, të përziera, konstipacion.
Të pazakonta: dhimbje barku, përgjumje, tharje goje, çrregullime të tretjes, rash, të vjella.
Të rralla: këputje, hipertoni, ileus paralitik, sindrom Stivens - Xhonson, nekrolizë epidermale toksike, retension urinar.
Në rastet e mbidozimit mund të shfaqet deprimim i sistemit nervor qendror, ndaj të cilit fëmijët dhe ata me dëmtim të funksionit të mëlçisë janë më të ndjeshëm.

Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI LOPERAMID

Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Loperamid pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani mbi 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia!

6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Loperamid – Tableta
Lënda vepruese është loperamid klorhidrat.
Çdo tabletë përmban 2 mg loperamid klorhidrat.
Përbërësit e tjerë janë: laktozë, stearat magnezi, celulozë mikrokristalore, talk.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 20 tableta.

Shpjegues i ikonave ilustruese për paketim:

Mund të merret pa recetën e mjekut.

Përmbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Mbajtësi i autorizimit të tregtimit (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI

Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në: Shtator 2012.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 X 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.